



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2024:162892
Datë: 17.12.2024
Numri i dokumentit: 06610525

P.nr. 132/24

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË- Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe Sekretaren Juridike Behije Karaçica, në çështjen penale ndaj të akuzuarit U.K., për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës PP/II.nr.656/23 të dt. 28.06.2024, pas mbajtjes të shqyrtimit fillestar, të dt.12.12.2024 ku prezent ishin Prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari U.K. se bashku me mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu me autorizim, me dt.13.12..2024, shpallë, ndërsa me dt. 17.12.2024 e përpilon këtë:

AKT GJYKIM

I AKUZUARI: U.K. nga i ati H. dhe e ëma N. e lindjes H., i lindur me dt.... në fshatin B. komuna e Malishevës, ku edhe jeton, me nr. personal ... shqiptar, shtetas i R të Kosovës, i martuar, i ati i 5 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punëtor privat, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë SHTË F A J T O R

Për shkak se nga data e pa vërtetuar e deri me datë 28.04.2024 rreth orës 23:00/h, në Fsh.B. K. Malishevë, saktësisht në shtëpinë e tij, i dyshuari posedon armë në kundërshtim me Ligjin nr.05/L -22 për Armë, ashtu në atë mënyrë ditën kritike i pandehuri posedon armën- pistoletë me gaz të tipit „B. M.”, 92 kalibri 9mm, prodhim I., pa nr.serik, dhe një karikator adekuat i kësaj arme e për të cilën armë nuk posedonte leje valide nga organi kompetent, e cila armë është sekuestruar nga zyrtaret policor.

- me çka ka kryer veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata konform nenit 4,7,17, 38, 39, 40, 43 dhe 69 të KPRK-së, nenit 366 par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 364, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës të njëjtit ia shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej **shtatëqind** euro (700€), të cilën shumë e akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar me gjobë do të iu zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej tridhjetë e pesë ditësh (35), duke llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu.

Konform nenit 366 par.3 të KPRK_së, të akuzuarit i shqiptohet dënimi plotësues ashtu që i konfiskohet pistoleta të tipit „B. M.”, 92 kalibri 9mm, prodhim I.. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, kjo armë duhet të shkatërrohet nga policia e Kosovës, me bashkëpunim me Prokurorinë Themelore në Gjakovë. pasi që të vërtetohet se kjo armë nuk është përdorur në ndonjë krim tjetër.

Obligohet i akuzuarit në emër të paushallit gjyqësor gjykatës t`ia paguajnë shumën prej tridhjetë (30) euro, për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime të procedurës penale nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën ekzekutimi do të bëhet me detyrim.

A r s y e t i m

1. Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II.nr. 656/23 të dt. 28.06.2024 e ka akuzuar U.K.n, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor si dhe administrimit të provave, të akuzuarin t`a shpall fajtor dhe t`a dënoj në bazë të ligjit.

Gjykata ka mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar me dt. 12.12.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës, prokurori i shtetit Venera Shala, i akuzuari U.K., se bashku me mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu me autorizim, andaj ka pasur kushte për mbajtjen e shqyrtimit fillestar.

I akuzuari U.K., në shqyrtimin fillestar pas konsultimit paraprak me mbrojtësin e tij av. Agron Kryeziu është deklaruar i fajshëm për veprën penale për të cilën ngarkohet, duke shtuar se me vjen keq për rastin i cili ka ndodhur për të cilën jam penduar, ky ka qenë rasti im i parë që kam rënë ndesh me ligjin.

Mbrojtësi i te akuzuarit, Av. Agron Kryeziu ka deklaruar: Pas konsultimit të mjaftueshëm që e pata me të mbrojturin tim U.K. i njëjti e pranon fajësinë, lidhur me veprën penale për të cilën ngarkohet në aktakuzë, i njëjti edhe ne polici edhe në prokurori e ka sqaruar rastin se këtë armë e ka dhuratë nga një shok I. që e ka sjellur para 10 viteve në Kosovë dhe nuk ka qenë në dijeni se për këtë lloj të armës

me gaz duhet të ketë leje nga organi kompetent i Ministrisë së Punëve të Brendshme krejt kete duke marr për bazë se i pandehuri është palë laike dhe nuk e ka kuptuar se

për këtë duhet të ketë leje përkatëse për armë. Propozoj që të aprovohet pranimi i fajësisë nga ana e mbrojturit tim,. Pasi që i mbrojturi im i ka kuptuar benifitet e pranimit të fajësisë të njëjtën e ka pranuar në mënyrë vullnetare, andaj i propozojmë gjykatës që me rastin e pranimit të fajësisë të merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese siç janë pranimi i fajit, është hera e parë që bije ndesh me ligjin, është mbajtës i familjes prej 26 anëtarëve, punon në sektorin e ndërtimitarisë në punë sezonale, pendimin, mos dijen se duhet të ketë leje përkatëse, andaj i propozoj gjykatës që më rastin e matjes së dënimit të ketë parasysh dhe ti shqiptoj një dënim të kushtëzuar.

Prokurori i shtetit Venera Shala në shqyrtimin fillestar ka deklaruar se: Nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit U.K., duke marr parasysh që i njëjti u sqarua mjaftueshëm nga ana e gjykatës e po ashtu edhe konsultimeve me mbrojtjen e tij lidhur me benefietet dhe pasojat e pranimit të fajësisë, andaj konsideroj që pranimi i fajësisë këtu nga ana e të akuzuarit është një shprehje e lire e vullnetit të tij. Pranimi i fajësisë këtu nga ana e të akuzuarit na konform gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktakuzës e po ashtu kjo aktakuzë nuk përmban shkelje ligjore apo gabime faktike, andaj i propozoj gjykatës që ta pranoj si të tillë.

Sa i përket caktimit dhe llojit dhe lartësisë së dënimit nga gjykata i propozoj gjykatës që si rrethanë lehtësuese të ketë parasysh pranimin e fajësisë këtu nga ana e të akuzuarit, ndërkaq sa i përket rrethanave rënduese kërkoj nga gjykata që të merr parasysh përgjegjësinë penale të të akuzuarit si dhe shkallen e rrezikshmërisë së kësaj veprë penale e cila i kanoset shoqërisë. Gjithashtu i propozoj gjykatës që në mbështetje të nenit 366 par.3 të KPRK-së dhe nenit 269 par.1 , 276 par.1 dhe 2, të KPPK-së, të konfiskohet pistoleta me gaz e tipit „B. M.” 92 kalibri 9mm ashtu siç është propozuar në pikën III të aktakuzës.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, për shkak të cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 242 të KPPRK-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoj se i akuzuari i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

- se i akuzuari U.K. me dashje ka kryer veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 prg.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivet e këtij aktgjykimi.

Gjendjen e këtillë faktike e mori në tërësi ashtu siç ishte përcaktuar në aktakuzë dhe në provat të cilat i përmbante aktakuza, e ato janë:

- Procesverbalin e marrjes në pyetje të të pandehurit U.K., dhënë në Prokurori në prezencën e mbrojtësit të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Muhamet Delija më datë 28.06.2024;
- Fotografia nga vendi i ngjarjes ku shishen arma me gaz të tipit „B. M.”, 92 kalibri 9mm, prodhim I., pa nr.serik dhe një karikator ;
- Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 366 par.1 është paraparë se „ *Kushdo që mban në pronësi, kontrollon ose posedon armë në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm lidhur me armë të tilla, dënohet me gjobë deri në shtatë mijë e pesëqind (7.500) Euro ose me burgim deri në pesë (5) vjet.*

5. Vendimi i gjyqtarit të vetëm gjykues.

Duke u bazuar në këto që u ceken me lart gjyqtari i vetëm gjykues të akuzuarin U.K. e ka shpallur fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet, nga se në veprimet e tij të përshkruara si në dispozitivin e aktgjykimit, formohen të gjitha elementet e veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 prg.1 të KPRK-së, për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtor dhe ta gjykoj në bazë të ligjit, e me parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-së ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, është i gjendjes së dobët ekonomike, është i ati i 5 fëmijëve , mbajtës i familjes prej 26 antarësh, me punë në sektorin privat kohë pas kohe në ndërtimtari, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa duke mos gjetur rrethana rëndues, i shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej shtatëqind (700) euro të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj 30 ditë pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e shqiptuar ndaj të akuzuarit

mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

7. Konfiskimi i armës

Konform nenit 366 par. 3 të KPRK-së, të akuzuarit i konfiskohet pistoleta e të tipit „B. M.”, 92 kalibri 9mm, prodhim I..

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Vendimi paushallin gjyqësor dhe shpenzimet e procedurës penale është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 të KPPK-së.

Ndërsa vendimi në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha me lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË-
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr. 132/24, me dt. 13.12.2024.**

Sekretarja juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.